



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:025128
Datë: 21.09.2023
Numri i dokumentit: 04706090

Pml.nr.488/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Agim Maliqi dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit D. S., për shkak të veprave penale “*Vrasje e rëndë në tentativë*” nga neni 173 lidhur me nenin 28 dhe nenin 32 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), “*Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*” nga neni 356 të KPRK, “*Lëndimi i rëndë trupor*” nga neni 186 të KPRK, “*Detyrimi*” nga neni 328 i KPRK, “*Zjarrvënia*” nga neni 322 të KPRK dhe “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Halit Shaljani, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.636/2022 të datës 20.7.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.822/2023 të datës 1.8.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 21.9.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit D. S., e sipas detyrës zyrtare edhe për të pandehurit Xh. M., H. H. dhe T. Sh., anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.636/2022 të datës 20.7.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN1.DKR.nr.822/2023 i datës 1.8.2023, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. Të pandehurit mbeten në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.636/2022 të datës 20.7.2023, të pandehurve D. S., Xh. M., H. H. dhe T. Sh., për shkak të veprave penale “*Vrasje e rëndë në tentativë*” nga neni 173 lidhur me nenin 28 dhe nenin 32 të KPRK, “*Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*” nga neni 356 të KPRK, “*Lëndimi i rëndë trupor*” nga neni 186 të KPRK, “*Detyrimi*” nga neni 328 i KPRK, “*Zjarrvënia*” nga neni 322 të KPRK dhe “*Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 366, paragrafi 1. të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve dhe atë duke filluar nga data 23.7.2023 deri më 23.9.2023. Të pandehurve paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1. nën paragrafi 1.1, e 1.2, nën paragrafi 1.2.1, 1.2.2, dhe 1.2.3, të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN.1.nr.822/2023 të datës 1.8.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve D. S., Xh. M., H. H. dhe T. Sh., dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit D. S., avokati Halit Shaljani, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar, aktvendimet e kundërshtuara të anulohen ose të ndryshohen ashtu që të pandehurit t’i ndërpritet masa e paraburgimit.

Kryeprokurori i shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.204/2023 e datës 18 shtator 2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar për dy muaj edhe pse kërkesa e prokurorit të shtetit për vazhdimin e paraburgimit për të pandehurin ishte për një muaj dhe atë deri me datën 23.8.2023. Mbrojtësi i të pandehurit i ka paraqitur këto shkelje në ankesën e tij drejtuar gjykatës së shkallës

së dytë, mirëpo kjo gjykatë e ka refuzuar ankesën e tij dhe fare nuk e ka shtjelluar pretendimin e tij lidhur me tejkalimin e kërkesës së prokurorit të shtetit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit, se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 2. nën paragrafi 2.1. të KPP, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta gabimisht kanë aplikuar dispozitat e KPP lidhur me vazhdimin e masës së paraburgimit.

Gjatë fazës së hetimit, paraburgimi vazhdohet vetëm në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, konform dispozitës së nenit 188, paragrafi 1. të KPP, ndërsa nga kërkesa për vazhdimin e paraburgimit, PP.I.nr.872/2022 e datës 17.7.2023, ka qenë për një muaj deri me datën 23.8.2023, ndërsa të pandehurve masa e paraburgimit u është vazhduar për dy muaj.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë, të shqyrtojë shkresat e lëndës me kujdes, dhe të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm, duke i respektuar dispozitat e KPP, mbi vazhdimin e masës së paraburgimit konform kërkesës së prokurorit të shtetit.

Përkundër faktit se të pandehurit Xh. M., H. H. dhe T. Sh., nuk kanë ushtruar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, kjo Gjykatë vlerësoi se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të pandehurit D. S., e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të pandehurve tjerë, të cilët nuk kanë parashtruar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, andaj konform nenit 397 të KPP – *beneficium cohaesionis*, vendosi edhe për këta të pandehur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438, paragrafi 1. nën paragrafi 1.2. të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.488/2023, më 21.9.2023

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala